

20211492460

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në bazë të nenit 26-a nga Ligji për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 110/21), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi

**VENDIM PËR KUSHTET DHE MËNYRËN E MBIKËQYRJES GJATË
FURNIZIMIT ME KARTËMONEDHA DHE MONEDHA**

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

1. Me këtë vendim përshkruhen kushtet dhe mënyra e mbikëqyrjes gjatë furnizimit me kartëmonedha dhe monedha (në tekstin e mëtejshëm: para të gatshme).

II. KUSHTET DHE MËNYRA E MBIKËQYRJES

Mbikëqyrja e kushteve të nevojshme për kryerjen e aktiviteteve të furnizimit me para të gatshme

2. Mbikëqyrjen e përbushjes së kushteve të nevojshme për kryerjen e aktiviteteve të furnizimit me para të gatshme furnizimin me para të gatshme nga ana e bankave dhe kompanitë për furnizimin me para të gatshme (në tekstin e mëtejshëm: qendrat për para të gatshme), të cilat janë shoqata tregtare të regjistruara në regjistrin tregtar, të cilat i plotësojnë kushtet për furnizimin me para të gatshme të përcaktuara me rregullativë, e kryen Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm: Banka Popullore) nëpërmjet kontrolleve të jashtme të dokumenteve me të cilat dëshmojnë kushtet për furnizim me para të gatshme dhe kontrolleve të jashtme të mjeteve dhe hapësirës afariste ku do të vendosen, ruhen dhe përpunohen parat e gatshme.

Mbikëqyrja e zbatimit të kushteve dhe mënyrës së furnizimit me para të gatshme

3. Banka Popullore kryen mbikëqyrjen e zbatimit të kushteve dhe mënyrës së furnizimit me para të gatshme nga ana e bankave dhe qendrave për para të gatshme nëpërmjet:

- kontrollës dhe analizës së të dhënave të cilat i dorëzojnë bankat dhe qendrat për para të gatshme në bazë të rregullativës së Bankës Popullore; dhe

- kontrollit të drejtpërdrejtë, të plotë ose të pjesshëm në terren (me lajmërim ose pa lajmërim) tek bankat dhe qendrat për para të gatshme.

Gjatë kontrollës vërtetohet zbatimi i ligjëshmërisë, procedurat për performancën e makinave, përpunimi i parave të gatshme dhe trajtimin me paratë e përpunuara.

Banka Popullore mund të marrë ekzemplarët e parave të përpunuara nga bankat dhe qendrat për para të gatshme për t'i kontrolluar në lokalet e saj.

Kontrollet e jashtme nga paragrafi 1 alineja 2 e kësaj pike i kryejnë persona të autorizuar, të përcaktuar me vendim të guvernatorit të Bank[ës Popullore, me të cilën përcaktohet edhe lënda e kontrollës.

4. Kontrolla e paralajmëruar të jashtme kryhet në bazë të planit për kontrolle të jashtme, i miratuar nga ana e guvernatorit të Bankës Popullore.

Gjatë përgatitjes së planit për kontrollë, meren parasysh:

- madhësia e bankave dhe qendrave për para të gatshme;
- dobësitë në punë të konstatuara gjatë kryerjes së kontrolla të mëparshme të jashtme; dhe
- parregullsitë e konstatuara në punë gjatë kontrolleve të mapërshme të të dhënave të cilat i dorëzojnë rregullisht në bazë të rregullativës së Bankës Popullore.

5. Për kontrollën e paralajmëruar të jashtme, Banka Popullore dërgon njoftim deri tek banka/qendra për para të gatshme më së voni 15 ditë para se të filloj kontrolla të jashtme. Njoftimi përmban:

- të dhëna për lëndën e kontrollës;
- të dhëna për personin e autorizuar që do të udhëheq me kontrollën;
- data e fillimit të kontrollës;
- kohëzgjatja e paraparë për kontrollën;
- listën e të dhënave që duhet ti përgatit banka / qendra për para të gatshme për nevojat e kontrollës;
- afati dhe mënyra e dorëzimit të të dhënave të kërkuara.

Të dhënat që duhet ti përgatit banka / qendra për para të gatshme për nevojat e kontrollës, duhet të jenë plotë, të sakta dhe përfundimtare.

6. Pas përfundimit të kontrollës, Banka Popullore përgatit procesverbal i cili dërgohet tek banka / qendra për para të gatshme.

Procesverbali i përmban këto elemente:

- vëzhgimet përfundimtare veçmas për çdo fushë të përfshirë në kontrollën e jashtme;
- rishikim i detajuar i të gjitha gjetjeve nga kontrolli që kanë të bëjnë me dobësitë e vërtetuara ose parregullsive gjatë punës;
- gjetjet të cilat paraqesin papajtueshmëri me rregullativën ligjore dhe nënligjore përkatëse; dhe
- reagueshmëria e bankës / qendrës për para të gatshme tek parregullsitë e konstatuara më parë nga Banka Popullore.

7. Procesverbali nga kontrolla e kryer paraqet fshehtësi profesionale të Bankës Popullore dhe bankat / qendrat për para të gatshme janë të obliguar ta ruajnë në bazë të Vendimit për qasje dhe mënyra e përdorimit të të dhënave të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë që nuk janë publike. Bankat dhe qendrat për para të gatshme mund ta citojnë ose në mënyrë tjetër ta përmendin përmbajtjen e procesverbalit nga kontrolla e kryer vetëm për nevojat e revizionit të raporteve financiare vjetore dhe librave tregatar, për analiza të thella të bankave dhe në raste të tjera të parapara me ligj, vetëm pas marrjes së lejes me shkrim nga ana e guvernatorit të Bankës Popullore.

8. Procesverbali nga kontrolla e kryer dërgohet tek antarët e Këshillit drejtues të bankës dhe organit udhëheqës tek qendrat me para të gatshme.

Antarët e Bordit drejtues të bankës janë të detyruar ta shofin procesverbalin nga kontrolla e kryer, ti informojnë anëtarët e Këshillit mbikëqyrës për përmbajtjen e tij dhe të dorëzojnë një kopje të tij tek Shërbimi për revizion të brendshëm.

9. Bankat dhe qendrat për para të gatshme kanë të drejtë të dorëzojnë kundërshtim ndaj procesverbalit. Kundërshtimi duhet të dorëzohet në afatin e përcaktuar nga Banka Popullore, i cili afat nuk mund të jetë më i shkurt se pesë ditë dhe më i gjatë se dhjetë ditë.

Në shtojcat e kundërshtimit, bankat dhe qendrat për para të gatshme duhet të dorzojnë njoftim për aktivitetet e ndërmara apo të planifikuara në lidhje me tejkalimin e parregullsive me rregullativën ose dobësitë e paraqitura në procesverbal.

Banka Popullore është e obliguar të dorëzoj përgjigje të kundërshtimit ndaj procesverbalit në afat prej peëmbëdhjet ditë, nga dita e pranimit të ankesës, pas së cilës edhe oficijalisht do të konsiderohet se kontrolla ka mbaruar dhe procesverballi është përfundimtar.

10. Në rastet kur gjatë kontrollës do të vërtetohet se veprohet në kundërshtim me dispozitat e këtij vendimi, Banka Popullore inicon procedurë për kundërvajtje ndaj bankave dhe qendrave për para të gatshme në pajtim me ligjin dhe varësisht nga parregullësia, mund të prish kontratën e lidhur me qendrat për para të gatshme.

Në raste të defektit të makinës për përpunimin e parave i cili nuk mund të rregullohet, banka Popullore mund ta fshijë makinën nga lista e shpallur në internet faqen e Bankës Popullore.

III. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE DHE KALIMTARE

11. Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e shpalljes në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

V. nr. 02-15/IX-2/2021
30 qershor viti 2021
Shkup

Guvernator
dhe kryetar i Këshillit
të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë së Veriut
D-r. Anita Angelovska-Bezhoska